

AKT THEMELIMI
I SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR
“ FSHATCE” Sh.p.k

Sot ne daten 03 Mars 2022 (dymije e njezet e dy), Z. Gentian Lalaj, i biri i Xhevitit dhe Sanies I datelindjes 22.06.1976 adresa :Tirane identifikuar ne baze te kartes se identitetit 033642540 cili bazuar ne Ligjin Nr.9901 ,date 14.04.2008 **“Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare te Ndryshuar”**dhe nenet perkatese te Kodit Civil te Republikes se Shqiperise ne fuqi , I cili nepermjet ketij **Akt Themelimi** , themelon Shoqerine **“FSHATCE “sh.p.k** e cila perbehet nga nenet e meposhtme

KAPITULLI I
FORMA, EMERTIMI, OBJEKTI,SELIA, KOHEZGJATJA

Neni 1 – Forma

- 1.1. Shoqeria **“FSHATCE”** Sh.p.k. (ne vijim **“Shoqeria”**) eshte nje shoqeri me pergjegjesi te kufizuar, veprimtaria e se ciles do te rregullohet me ane te ketij Statuti dhe nga legjislacioni ne fuqi.
- 1.2. Shoqeria vepron sipas legjislacionit shqiptar ne fuqi.
- 1.3. Ky Statut eshte perpiluar ne perputhje me legjislacionin shqiptar qe ka karakter te detyrueshem, ndersa ceshtjet qe nuk jane shprehimisht te parashikuara ne to, plotesohen nga legjislacioni shqiptar.

Neni 2 – Emertimi

Emertimi I Shoqerise eshte **“FSHATCE”** Sh.p.k.

Neni 3 – Objekti I shoqerise

Aktiviteti kryesor I shoqerise eshte : Grumbullim,perpunim e tregtim te bulmetit(qumesht,kos,djath e gjithe nenproduktet e tyre).Import-eksport..Transport te bulmetit e te nenprodukteve te tij.Grumbullim,prodhim, perpunim,stampim ne forma te ndryshme te qumeshtit , tregtim me shumice dhe me pakice te nenprodukteve te qumeshtit

Neni 4 – Selia

- 4.1. Selia e Shoqerise eshte **Fier, Rruga Llaqi Jano,ndertese 1 kateshe Zona kadastrale 2443, Numer pasurie 127/4 ,Libofshe**
- 4.2. Transferimi I selise se Shoqerise ne nje vend tjeter behet me vendimin e Asamblese se Ortakeve.



4.3. Asambleja e Ortakeve mund te vendose, hapjen e filialeve, selive dytesore, degeve dhe perfaqesive te Shoqerise ne qytete te tjera te Shqiperise, dhe jashte shtetit. Asambleja e Ortakeve mund t'ia delegoje kete competence organit administrativ.

Neni 5 – Kohezgjatja e veprimtarise

5.1. Kohezgjatja e veprimtarise se Shoqerise eshte e pakufizuar ne kohe.

5.2. Shoqeria mund te priset perpara ketij afati me vendim te Asamblese se Ortakeve.

KAPITULLI II

KAPITALI THEMELTAR, KONTRIBUTET, NDARJA DHE TRANSFERIMI I KUOTAVE.

Neni 6 – Kapitali themeltar

6.1. Kapitali themeltar I shoqerise eshte 300.000(treqindmije) leke.

Kapitali themeltar I shoqerise perbehet nga 1 kuote te Kapitalit, me vlere nominale 300.000 (treqindmije) leke.

6.2. Kapitali themeltar I shoqerise zoterohet nga ortaku I vetem **Z. Gentian Lalaj**.

Neni 7 – Rritja e kapitalit themeltar

7.1. Kapitali themeltar mund te rritet pa kufi ne cdo moment, nje ose disa here, ne perputhje me legjislacionin ne fuqi. Rritja e kapitalit behet vetem me vendim te Asamblese se Ortakeve. Vendimi I vlefshem merren vetem nese ortaket jane te pranishem personalisht, votojne me shkrese, apo mjete elektronike, sipas parashikimeve te pikes 3 te nenit 88 te ligjit Nr. 9901 dt 14.04.2008 “ Per Tregetaret dhe Shoqerite Tregetare “.

Neni 8 – Zvogelimi I kapitalit themeltar

8.1. Shoqeria mund te zvogeloje kapitalin themeltar. Zvogelimi I kapitalit behet me vendim unanim te Asamblese se Ortakeve. Ne cdo rast kapitali themeltar nuk mund te zvogelohet nen kufijte e parashikuar nga ligji.

8.2. Zvogelimi I kapitalit perballohet nga secili prej ortakeve ne te njejten mase me pjeset e kapitalit te zoteruara prej tyre.

Neni 9 – Transferimi I kuotave

9.1. Transferimi I kuotave kushtezohet nga e drejta e parablerjes se ortakeve.

9.2. ne nje rast te tille, ortaku qe do te transferoje kuotat e tij ta kapitalit duhet ti njoftoje ortaket e tjere, me leter rekomande me kthim pergjigje dhe/ose me Leter Njoftim nepermjet adreses elektronike (ne vijim “Njoftimi”), (a) numrin e kuotave te ofruar ; (b) emrin e bleresit/perfituesit ; (c) cmimin e rene dakort per cdo kuote, I percaktuar ne cdo rast ne para, ose ne vleren ne para ne rastin e nje

kundershperblimi tjetër të mundshëm (në rast shkëmbimi, kompensimi vullnetar, transaksioni, dhe çdo rast tjetër transferimi me shperblim), ose vlerën e objektit të transferimit në rastin e transferimit pa shperblim; (d) modalitetet e pageses; (e) ftesën për të ushtruar të drejtën e parablerjes. Afatet dhe kushtet e mundshme për të cilat është rënë dakort midis transferuesit të kuotave dhe bleresit/perfituesit nuk do të jenë detyruese për ortakët e tjerë të cilët do të ushtrojnë të drejtën e parablerjes. E drejta e parablerjes I referohet të gjitha kuotave të kapitalit ofruar për shitje.

9.3. Ortakët do të kenë në dispozicion 30 (tridhjetë) ditë nga marrja e Njoftimit, për të komunikuar ortakut që transferon kuotat, synimin e tyre për të ushtruar apo jo të drejtën e parablerjes. Në rast se ata nuk përgjigjen në afatin e caktuar, prezumohet se kanë hequr dorë nga e drejta e tyre e parablerjes.

9.4. Në rast se oferta pranohet nga disa ortakë, kuotat e ofruara nga ortaku që transferon kuotat, do të ndahen nga ortakët pranues, në të njëjtën masë me kuotat që ata zotrojnë, përveç rasteve kur ka një marrëveshje të kundërt. Në asnjë rast, pranuesi I ofertës nuk mund të ushtrojë pjesërisht të drejtën e parablerjes.

9.5. Në rast se nuk ushtrohet e drejta e parablerjes, kuotat e ofruara në njoftim mund të transferohen të treta sipas cmimit të specifikuar në të.

KAPITULLI III

ASAMBLEJA, ADMINISTRATORET DHE EKSPERTET KONTABEL

Neni 10 – Asambleja e ortakëve dhe kompetencat e saj

10.1. Organi vendim-marrës I Shoqërisë është Asambleja e Ortakëve.

10.2. Asambleja e ortakëve është përgjegjëse për marrjen e vendimeve për çështjet vijuese: ndryshimet e statutit, emerimi dhe shkarkimi I administratorëve, ekspertëve kontabel e likuidatorëve, zmadhimi dhe zvogëlimi I kapitalit, transferimi I kuotave, shpërndarja e fitimeve, riorganizimi dhe prishja e shoqërisë, miratimi I bilancit dhe për çdo vendim tjetër parashikuar nga ky Statut apo nga legjislacioni përkatës.

Neni 11 – E drejta e pjesëmarrjes dhe e votës

11.1. Çdo ortak ka të drejtë të marrë pjesë në Asamble, të paraqes mendimin e tij dhe të japë atë votë sa është numri I kuotave që ai zotron.

11.2. Çdo ortak ka të drejtë të përfaqësohet nga një person tjetër jo-ortak, I pajisur me procure me shkrim, me anën e së cilës mund të japë votën e tij.

11.3. Ortaku nuk mund të leshojë procure për votim vetëm për një pjesë të kapitalit që zotron.

Neni 12 – Thirrja e Asamblese së Ortakëve, Kuorumi dhe Vendimet

12.1. Asambleja e Ortakëve thirret të paktën një herë në vit, Brenda 6 (gjashtë) muajve nga mbyllja e vitit financiar për miratimin e bilancit, të raportit të Administratorit/ve, dhe /ose ekspertit kontabel (nëse është emëruar) si dhe inventarit.

12.2. Asambleja mund të thirret në çdo moment prej Administratorit me iniciativën e tij ose sipas kërkesës që do të drejtohet Administratorit nga një ose disa prej ortakëve që përfaqësojnë të paktën 5 % (pese përqind) të kapitalit themeltar. Asambleja thirret nepermjet : a) njoftimit me leter rekomande me kthim pergjigje, b) Faksit ; C) Poste elektronike.

Njoftimi me poste elektromike konsiderohet I kryer me kalimin e 10 (dhjete) diteve kalendarik nga nisja e njoftimit. Njoftimi per secilin ortak dergohet ne adresat respective pershkruar ne hyrje te ketij akti.

12.3. Lajmerimi do të dërgohet ortakëve, të paktën 15 (pesëmbëdhjete) dite përpara mbledhjes së Asamblesë. Thirrja duhet të përmbajë informacion mbi llojin e Asamblesë, mbi çështjet që do të trajtohen dhe për të cilat do të merret vendim, mbi vendin, orën dhe datën e thirrjes.

12.4. Në rast se Asambleja e Ortakëve nuk mbledhet me thirrjen e parë për mungesën e kuorumit, Asambleja e Ortakëve do të thirret Brenda 15 (pesëmbëdhjete) ditësh me të njëjtin rend dite.

12.5. Mbledhjet e Asamblesë mund të mbahen edhe nepermjet teleconferencës, me kusht që të gjithë pjesëmarrësit të mund të identifikohen dhe të lejohet atyre të ndjekin diskutimin dhe të ndryjnë në momentin e trajnimit të çështjeve në rend të ditës; pasi të jenë verifikuar këto kërkesa që duhet të rezultojnë në procesverbalin e mbledhjes.

12.6. Asambleja konsiderohet e mbajtur rregullisht nëse Asambleja mbledhet në seline të shoqërisë. Asambleja konsiderohet se mbahet rregullisht edhe pa respektimin e formaliteteve të njoftimit e të vendmbajtjes në rast se janë të pranishëm ortakët që përfaqësojnë të paktën kapitalin themeltar.

12.7. Vendimet e Asamblesë së Ortakëve, për të cilat kërkohet një shumicë e thjeshtë, janë të vlefshme nëse janë të pranishëm ortakët me të drejtë vote që zotërojnë më shumë se 51% (pesëdhjete e një përqind) të kapitalit themeltar.

12.8. Për drejtimin e punëve në çdo Asamble zgjidhet një kryetar, ortak ose ndonjë person tjetër jo-ortak i caktuar nga votat e Asamblesë. Për pasqyrimin e vendimit të Asamblesë emëron një Sekretar, që mund të jetë edhe jo-ortak.

12.9. Vendimet e Asamblesë duhet të nënshkruhen nga Ortakët.

Neni 13 - Njoftimi

13.1 Njoftimi I ndërsjellë ndërmejt Administratorit, Personelit drejtues dhe bashkëpunetoreve të shoqërisë, do të realizohet nepermjet : a) njoftimit me leter rekomande, e kthim pergjigje, b) Faksit, c) poste elektronike, d) njoftimit në faqen zyrtare elektronike të shoqërisë

13.2 Njoftimi me poste elektronike konsiderohet I kryer me kalimin e 10 (dhjete) diteve kalendarike nga nisja e njoftimit. Njoftimi per secilin ortak dergohet ne adresat respective pershkruar ne hyrje te ketij akti. Administratori, personeli drejtues dhe bashkëpunetoret e kontaktuar nga shoqëria duhet të depozitojnë adresën e tyre elektronike në shoqëri.

13.3 Njoftimi nepermjet faqes zyrtare te shoqerise konsiderohet I kryer me kalimin e 10 (dhjete) diteve kalendarike nga publikimi I njoftimit ne faqenzyrtare elektronike te shoqerise .

Neni14- Administrimi

- 14.1 Administratori emerohet dhe shkarkohet me vendim te Asamblese se pergjithshme te ortakeve .
- 14.2 Perfaqesimi ligjor I shoqerise I besohet Z. Gentian Lalaj
- 14.3 Administratori emerohet ne kete detyre per nje afat kohor 5(pese) vjecar .
- 14.4 Administratori I shoqerise gezon te drejtat e administrimit te zakonshemshoqerise pa kufizime
- 14.5 Administratori mund te emeroje perfaqesues te posacem per veprime apo kategori te caktuara veprimesh

Neni 15- eksperti kontabel I autorizuar

- 15.1 Ne rast se kerkohet nga nga ligji apo vendoset nga Asambleja e ortakeve ,kontrolli I bilanceve dhe librave kontabel te shoqerise mund ti besohet nje ose disa eksperteve kontabel te autorizuar .
- 15.2 Eksperti kontabel I autorizuar mund te shkarkohet sipas menyres se parashikuar nga legjislacioni ne fuqi.

KAPITULLI IV

VITI FINANCIAR ,BILANCI VJETOR, SHPERNDARJA E FITIMEVE

Neni16- Viti financiar dhe bilanci vjetor

- 16.1 Viti fianaciar fillon ne 01 Janar dhe mbaron ne 31 Dhjetor te secilit vit
- 16.2 Bilancet vjetore , inventari, raportetm e Administratorit dhe ekspertit kontabel te autorizuar miratohen nga Asambleja me shumicen e kerkuar nga Ligji n.9901 te dates 14.04.2008 “Per tregtaret dhe shoqerite tregtare “
- 16.3 Miratimi I dokumentave qe lidhen me vitin financiar duhet te bhet Brenda 6(gjashte) muajve qe nga fundi I vitit financiar

Neni 17- Fitimet

- 17.1 Fitimet qe rezultojne nga bilanci vjetor , u shperndahen ortakeve ne proporcion me pjeset e kapitalit themeltar te zoteruara .
- 17.2 Asambleja mund te vendose zbritje te vecanta ne favor te rezervave te jashtezakonshme ose per qellime te tjera apo per shtyrjen e shperndarjes se fitimeve plotesisht ose pjesisht , per vitet finaciara te ardhshme .



KAPITULLI V

SHPERNARJA DHE LIKUJDIMI I SHOQERISE

Neni 17- Prishja

18.1 Shpoqeria mund te priset ne rastet e parashkuara nga ligji , ose me ane ten je vendimi te asamblese se Ortakeve , me shumicen e kerkuar per ndryshimet ne statut.

18.2 Shoqeria nuk priset ne rast te humbjes se zotesise per te vepruar , vdekjes ,ose falimentimit te ortakeve .

Neni 18- Likujdimi

19.1 Ne rast prishje , Shoqeria duhet te likujdohet

19.2 Per te administruar kete procedure , Asambleja emeron nje ose me shume likujdatore te cilet paraqesin raportet perfundimtare mbi gjendjen e aktivitet dhe pasivit te Shoqerise , mbi operacionet e likujdimit dhe mbi kohen e nevojshme per te perfunduar likujdimin.

19.3 Me perfundimin e procedures se likujdimit , Asambleja do te vendose mbi bilancin fianciar perfundimtar , mbi punen e kryer nga likujduesi dhe mbi perfundimin e procesit te likujdimit .

19.4 Pas pagimit te kreditoreve dhe mbledhjes se kredive , likuidatori do ti shperndaje te ardhurat perfundimtare te likuidimit ortakeve , per proporcion me pjeset e kapitalit te zoteruara prej tyre ne kapitalin themeltar .

Per cfare nuk eshte parashikuar ne kete statut do te zbatohet legjislacioni ne fuqi

Statuti hartohet ne ne 3 kopje origjinale .Nje kopje depozitohet ne Qendren Kombetare te Regjistrimit dhe kopjet e tjera ne seline ligjore te shoqerise .

ORTAKU I SHOQERISE

Z. Gentian Lalaj

